VENDIM
Nr.304, datë 28.4.2010

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË SHTETASIT ËNGJËLL GJONDREKAJ, NË ITALI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, në zërin "Shpenzime operative", t'i shtohet fondi prej 5 500 000 (pesë milionë e pesëqind mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të shtetasit Ëngjëll Gjondrekaj, në Itali.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Pagesa të bëhet kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit shëndetësor të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha